



RAPORTI I VEPRIMTARISE VJETORE

PROBLEMET E PROFESIONEVE TE EKR DHE KM MARRJA E VENDIMEVE PER PERMIRESIMIN E PUNES SFIDA DHE PRIORITETE

2013

Raporti vjetor

| Përmbajtja | faqe |
|---|-------------|
| I Funksionet e BMP | 3 |
| 1.1 Misioni, objektivi, funksioni | |
| 1.2 Kompetencat kryesore të BMP | |
| II Drejtimi dhe organizimi | 5 |
| 2.1 Përbërja dhe funksionimi i BMP | |
| 2.2 Burimet e financimit dhe stafi mbështetës. | |
| III Programi i Punës për 2013 | 6 |
| IV Aktiviteti për 2013 | 7 |
| 4.1 Vendime për zbatimin e funksioneve themelore | |
| 4.2 Mbi letrat ankimore dhe masat e marra | |
| 4.3 Kontrolli i Cilësisë së Auditimit të Entiteteve me interes publik. | |
| 4.4 Procesi i Certifikimit të kandidatëve për EKR dhe KM | |
| V Bashkëpunimi Institucional | 12 |
| 5.1 Angazhimi i BMP në Projektin e Bankës Botërore CFREP Albania | |
| 5.2 BMP – Anëtar i IFIAR | |
| 5.3 Bashkëpunimi me organizmat kombëtare | |
| VI Sfida dhe prioritete | 14 |
| 6.1 Prioritetet e BMP për 2014 | |
| 6.2 Kuari i ri rregullator ligjor | |

1. Funksionet e BMP

1.1 Misioni, objektivi, funksioni

Bordi i Mbikëqyrjes Publike u krijua në tetor 2009 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” dhe në mbështetje të VKM nr. 874 datë 12.08.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike të ekspertëve kontabël të regjistruar”. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është konstituuar me Urdhërin Nr.87 datë 28.10.2009 të Ministrit të Financave, në zbatim të Ligjit më sipër.

Subjekte të Mbikëqyrura nga BMP

- ❑ Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- ❑ Autoriteti i Certifikimit
- ❑ Autoriteti i Regjistrimit
- ❑ Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
- ❑ Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
- ❑ Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar

Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është të kontribuojë në nxitjen e qendrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të profesioneve kontabël.

Objektivi kryesor i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është rritja e besimit që auditimet ligjore dhe shërbimet e tjera profesionale të kryhen në një mjedis transparent të mbikëqyrur dhe të kujdeshëm dhe i shërbejnë interesit publik.

Funksioni themelor i veprimtarisë së BMP është Mbikëqyrja e profesionit të EKR dhe shoqërive audituese si drejtpërdrejt, duke mbikëqyrur të gjithë ekspertët dhe shoqëritë e auditimit, ashtu dhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të EKR.

1.2 Kompetencat kryesore të BMP sipas ligjit janë:

- Harton rregullat e funksionimit të Autoritetit të Certifikimit dhe procedurat e testimit të kandidatëve, të cilat i dërgohen për miratim Ministrit të Financave;
- Harton rregullat e funksionimit të Autoritetit të Regjistrimit të ekspertëve kontabël dhe shoqërive audituese, dhe procedurat e regjistrimit, të cilat i paraqiten për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë;
- Mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të certifikimit dhe regjistrimit të ekspertëve kontabël dhe të shoqërive audituese;
- Miraton formatin e regjistrimit publik të ekspertëve kontabël dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Autoriteti i Regjistrimit, dokumentacionin që duhet të paraqitet për regjistrim, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të ekspertëve të regjistruar në këtë regjistër;
- Miraton kodin e etikës të ekspertëve kontabël e të shoqërive audituese, të përgatitur

dhe të propozuar nga organizata profesionale e ekspertëve kontabël dhe mbikëqyr zbatimin në praktikë nga ekspertët kontabël të regjistruar, të kërkesave e parimeve të parashikuara në këtë kod;

- Miraton rregullat për organizimin e kontrollit të cilësisë, për përbërjen dhe mënyrën e përzgjedhjes së komitetit të cilësisë, si dhe dhënien e sigurisë për cilësinë, bazuar në propozimin e këshillit drejtues të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e ekspertëve kontabël, dhe kur është e nevojshme organizon kontrolle cilësie të drejtpërdrejta në lidhje me ekspertët kontabël të regjistruar të angazhuar në auditimin e pasqyrave financiare të njesive ekonomike, që sipas tij janë me interes të madh publik;
- Mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të ekspertëve kontabël;
- Miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave disiplinore, të cilat propozohen nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- Kryen në varësi të nevojave të vendimarrjes së tij, investigime shtesë për ekspertët kontabël dhe shoqëritë audituese;
- Shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- Miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
- Shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
- Shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij;
- Njeh organizatat e kontabilistëve të miratuar sipas kritereve të përcaktuara në Ligj,
- Miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre;
- Miraton masën e shpërblimit fiks për anëtarët e Autoritetit të Certifikimit, të Autoritetit të Regjistrimit dhe të komisioneve apo komiteteve, të parashikuara nga ligji nr. 10091, datë 05.03.2009;
- Miraton akte të tjera rregullatore, të cilat janë në kompetencën e tij;
- Miraton vendimet për përjashtimin nga detyrimi për kryerjen e stazhit profesional individëve që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 6 të nenit 15 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009;
- I dërgon për miratim Ministrinë të Financave përmbajtjen e dokumentacionit, që duhet të paraqitet nga shtetasit e huaj, mbajtës të titullit EKR ose ACCA dhe CPA, dhe nga shoqëritë e huaja të auditimit për regjistrimin e tyre në regjistrin publik të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar.

2. Drejtimi dhe Organizimi i BMP

2.1 Përbërja dhe funksionimi i BMP


BMP është një organ kolegjal në përbërjen e të cilit janë 7 anëtarë. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave përmes kriterëve të paracaktuara dhe një procedure konkurrese transparente për një periudhë prej 4 vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Kryetari dhe tre anëtarë të bordit duhet të jenë jo-praktikues të cilët kanë njohuri mbi çështjet e auditimit ligjor dhe fushat e lidhura me të. Tre anëtarët e tjerë të Bordit mund të ushtrojnë profesionin e tyre në praktikën publike. Përjashtimisht për mandatin e parë, dy anëtarë, që nuk e ushtrojnë profesionin, ose një anëtar, që e ushtron profesionin, emërohen për një mandat 3-vjeçar.

Gjatë vitit 2013 katër anëtarëve të BMP u përfundoi mandati 4-vjeçar. Sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 874 datë datë 12.08.2009 u kryen procedurat e emërimit të anëtarëve të rinj.

Për rrjedhojë BMP gjatë vitit 2013 pati ndryshime të cilat janë pasqyruar më poshtë:

1. Adriana BERBERI* Kryetar, jo ushtrues i profesionit
2. Luan ABAZI Anëtar, jo ushtrues i profesionit
3. Shkelqim FORTUZI Anëtar, jo ushtrues i profesionit
4. Thoma JANKO** Anëtar, jo ushtrues i profesionit
5. Margarita GJERGJI Anëtar, ushtrues i profesionit
6. Kristaq NDINI* Anëtar, ushtrues i profesionit
7. Esmeralda BALLUKU* Anëtar, ushtrues i profesionit

BMP në përmbushje të funksioneve të tij gjatë vitit 2012 ka zhvilluar 4 mbledhje dhe ka marrë 20 vendime. Vendimet e marra kanë patur një rëndësi në drejtim të konsolidimit të kuadrit ligjor, në drejtim të forcimit të mbikqyrjes së profesioneve kontabël në vendin tonë të cilat rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare të kompanive të biznesit, rregullojnë funksionimin dhe mbikqyrjen e misionëve të kompanive të auditimit. Vendimet e Bordit kanë synuar në realizimin e një mbikqyrje efektive në fushën e profesioneve kontabël. Korniza e auditimit është konceptuar si më poshtë:



* Emeruar ne dhjetor 2013.

**Emeruar ne periudhen tetor 2009 – nentor 2012 dhe i riemeruar.

- Emeruar ne periudhen dhjetor 2012 e ne vijim (tre anetaret e tjere).

2.2 Burimet e financimit dhe stafi mbështetës.

Gjatë periudhës që nga krijimi i Bordit e deri më tani, veprimtaria e tij është mbështetur me staf ekzekutiv të IEKA-s. Nga BMP janë caktuar Inspektorët për të investiguar çështje të ndryshme. Mbledhjet e BMP janë zhvilluar në ambjentet e IEKAs.

Shpërblimi i anëtarëve të BMP përballohet nga buxheti i shtetit sipas VKM nr. 418 date 27.06.2012 deri në 4 pagesa në vit për shumën 20.000 leke për anëtar.

Për arsye se në ligj nuk ka të parashikuar ndonjë mënyrë e mundshme për financimin e bordit, veprimtaria e tij ka qënë e kufizuar në përdorimin e burimeve të brendshme dhe në shumë raste anëtarët e BMP dhe stafi teknik kanë kryer punë pa pagesë. Mungesa e fondeve e ka bërë të pamundur pjesëmarrjen e anëtarëve të BMP në veprimtari profesionale të organizuara nga IFIAR. Gjatë vitit 2013, duke pasur parasysh përvojën ndërkombëtare të organizmave homologe, BMP i ka kërkuar Autoritetit të Certifikimit të kryejë pagesën e kuotës së anëtarësimit të BMP në IFIAR, gjë e cila arriti të realizohej nga IEKA në fillim të vitit 2013.

Nga stafi teknik është bërë i mundur publikimi i informacioneve të nevojshme për publikun. BMP ka një link në Webin e IEKA-s me emërtimin Bordi i Mbikqyrjes Publike.

3. Programi i Punës dhe Prioritetet e BMP për vitin 2013

BMP, veprimtarinë e tij e ka mbështetur në detyrimet e tij ligjore të renditura më sipër, dhe në Programin Vjetor të Punës së tij të miratuar nga Ministri i Financave.

Sipas Programit të Punës të vitit 2013, Bordi ka përcaktuar **Prioritetet për aktivitetin e tij në këto drejtime:**

I - Prioritetet për aktivitetin e Bordit të Mbikqyrjes Publike për vitin 2013

1. Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet e organizuara nga IFIAR.
2. Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative.
3. Angazhimi në projektin e Bankës Botërore – CFREP – Albania .
4. Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 të organizuara nga AC-ja

II - Implementimi i prioritetëve

II.1 Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet te brendshme si edhe ato të organizuara nga IFIAR.

Objektivi kryesor: Bashkëpunimi institucional me rregullatorët vendas si dhe me IFIAR dhe përfitimi i përvojës dhe njohurive të organizatave të ngjashme ndërkombëtare.

II.2 Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative;

Objektivi kryesor: Planifikimi dhe zbatimi i planit të kontrollit nga kontrollorët e BMP-s për auditimet e shoqërive me interes publik për PF të vitit 2013.

Përmirësimi i metodologjisë dhe njohurive që duhet të zotërojnë kontrollorët e BMP-s në kryerjen e misionit të kontrollit të cilësisë së auditimit të shoqërive me interes publik.

Rishikimi i planit të kontrollit të kryer nga IEKA për auditimet e PF të vitit 2012 dhe 2013 dhe rishikimi i rezultateve të kontrollit. Investigimi i cdo informacioni që ka të bëjë me cilësinë në punën e EKR-ve. Miratimi i vendimeve për masa disiplinore që vijnë nga IEKA.

II.3 Angazhimi në projektin e Bankës Botërore - CFREP-Albania për komponentin që ka lidhje me mbikqyrjen publike.

Objektivi kryesor: Bashkëpunimi me asistentët e këtij projekti dhe kontributi në përmirësimin e legjislacionit dhe rregulloreve që kanë lidhje me komponentin e BMP-s.

II.4 Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2014 të organizuara nga AC-ja;

Objektivi kryesor: Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2014 për zbatimin e rregullores dhe procedurave të testimit.

4. Aktiviteti i BMP gjatë 2013

4.1 Vendime për zbatimin e funksioneve themelore

Tashmë kanë kaluar pesë vjet nga krijimi i BMP. Në periudhën e parë roli i Bordit të Mbikqyrjes Publike konsistoi në implementimin e ligjit, në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore që bëjnë të mundur zbatimin e tij. Në këtë hark kohor BMP ka miratuar:

1. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Rregjistrimit
2. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Certifikimit (të ndryshuar);
3. Rregulloren për Investigimin dhe Disiplinën
4. Rregulloren e Kontrollit të Cilësisë (IEKA)
5. Rregulloren për Kontrollin e Cilësisë të BMP
6. Manualin e Kontrollit të Cilësisë të BMP
7. Kodin e Etikës të EKR
8. Regjistri publik i EKR
9. Statutet e Organizatave profesionale të Kontabilitetit
10. Etj

Gjatë vitit 2013 puna e BMP është fokusuar në mbikqyrjen dhe monitorimin sipas funksioneve dhe përgjegjësi kryesore të BMP, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha organizatat profesionale. Gjatë viti 2013 kemi realizuar detyrat më poshtë:

1. Hartimi dhe Miratimi i Programit të Punës së Bordit për vitin 2013.
2. Hartimi dhe miratimi i Raportit për veprimtarinë vjetore të BMP gjatë vitit 2013
3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Kontrollit të Cilësisë për vitin 2012, të paraqitur nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe propozimi për masa administrative si dhe dhënia e rekomandimeve:
 - për përmirësimin e mangësive në nivelin e vlerësimit,
 - për harmonizimin e vërejtjeve të konstatuara dhe vlerësimeve të dhëna,
 - për hartimin e një manuali kontrolli që ti përgjigjet kërkesave të standardeve profesionale.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2012 dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës. Kërkimi i informacioneve të mëtejshme për një çështje të ardhur në IEKA nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
5. Shyrtimi i Informacionit mbi Programet dhe kualifikimin e vijueshëm të EKR gjatë vitit 2012,
6. Miratimi i ndryshimeve në formatin e Regjistrit Publik të EKR sipas propozimit të IEKAs.
7. Hartimi dhe miratimi i ndryshimit në Kodin e Etikës të EKR për përcaktimin e kohëzgjatjes në vite (jo më shumë se 7 vite rresht) të kryerjes së auditimit në një shoqëri;
8. Kontrolli i zbatimit të kërkesave të ligjit mbi raportimin nga shoqëritë audituese për raportin e Transparencës, marrja e masave për shoqërinë audituese që nuk e ka zbatuar këtë detyrim.
9. Kontrolli i zbatimit të kërkesave të ligjit lidhur me ortakun e angazhimit të shoqërive audituese për të gjitha angazhimet e auditimeve ligjore të viteve financiare që mbyllen në 31.12.2011 dhe 31.12.2012. (në proces)
10. Shqyrtimi i Informacionit të dërguar nga DPPPP për problematikat e konstatuara në subjekte për vitin 2012 dhe dhënia rekomandimeve organizatave profesionale për tju dërguar një Kujtesë anëtarëve të tyre për respektimin e kërkesave të Ligjit 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”;
11. Informim nga organizatat profesionale mbi zbatimin e detyrimit ligjor dhe të Statutit të organizatës përkatëse mbi mandatin e organeve drejtuese.
12. Miratimi i Planit (preventivit) të shpenzimeve për sezonin e certifikimit 2013 si dhe i tarifës së regjistrimit të kandidatëve, i honorareve për anëtarët e AC, etj.
13. Hartimi miratimi dhe ndjekja e projektit me termat e referencës në kuadrin e projektit REPARIS të BB, të Komponenti 1: Përmirësimi i ligjshmërisë të kornizës ligjore në fushën e raportimit financiar të shoqërive duke e përafëruar me EU acquis; dhe të komponentit 3 “Krijimi dhe zhvillimi i një sistemi të mbikqyrjes publike”.
14. Hartimi i Projekt/Buxhetit të Bordit të Mbikqyrjes Publike me qëllim planifikimin e burimeve të mbulimit.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Këshillit Drejtues të IEKA-s për përjashtimin nga detyrimi për kryerjen e stazhit profesional të disa kandidatëve.

16. Mbikqyrja në mënyrë të drejtpërdrejtë i Procesit të certifikimit të kandidatëve për EKR dhe KM.
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor për analizën, problematikat dhe propozimet për përmirësime për procesin e certifikimit të vitit 2013.
18. Organizimi i punës për realizimin e kontrollit të cilësisë së shoqërive me interes publik, të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë nga BMP. Miratimi i Inspektorëve/rishikuesve të kontrollit të cilësisë.

4.2 Mbi letrat ankimore dhe masat e marra

Bordi i Mbikqyrjes Publike është autoriteti që ka kompetencën e marrjes së masave disiplinore për të gjitha rastet që bien ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si dhe që vendos për heqjen e të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë për shoqëritë audituese dhe ekspertët kontabël të regjistruar, deri dhe çregjistrimin nga regjistri publik.

Gjatë vitit 2013 në BMP janë adresuar çështjet më poshtë të cilat BMP i ka shqyrtuar me integritetin dhe kompetencën profesionale. Synimi kryesor i BMP ka qënë marrja e vendimeve që i shërben zgjidhjes së problemit dhe përmirësimit të situatës.

- I. Letër apeluese dërguar në datë 10.01.2013 për vendimin e KD të IEKAs për mospranimin në stazhin profesional të një aplikanti.

Vendimi i BMP në lidhje me çështjen e parë:

Bordi i Mbikqyrjes Publike pasi shqyrtoi rastin në fjalë e konsideron të drejtë dhe në pajtim me Ligjin vendimin e KD të IEKAs dhe ka vendosur që:

Pranimi i kandidatëve në stazhin profesional për Ekspert Kontabel të Regjistruar të bëhet vetëm për ata që kanë një diplomë universitare të nivelit të dytë për cdonjerën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të tjera me natyrë ekonomike.

Deri në një përmirësim të mundshëm të Ligjit 10091 datë 5.03.2009 nuk do të pranohen kandidatë me diploma universitare jo me profil ekonomik.

- II. Letër ankimore e ardhur në datë 13.05.2013 në të cilën trajtohen shqetësime lidhur me çështje të tilla si:
 - Auditimi i subjekteve nga EKR për një periudhë më shumë se shtatë vjet - moszbatim i nenit 42, pika 5 të ligjit për auditimin;
 - Moszbatimimi i nenit 42 pika 2, të ligjit të auditimit i cili kërkon që auditimi i shoqërive aksionare të bëhet nga më shumë se dy EKR, në shumicën e rasteve ato auditohen nga 1 EKR;
 - Mungesa e kontrollit mbi normimin e orëve të punës së EKR – ka EKR që kryejnë auditimin e 40-60 subjekteve në vit;
 - Kryerja e shërbimeve të mbajtjes së kontabilitetit dhe e auditimit për të njëjtat subjekte;

Vendimi i Bordit në lidhje me çështjen e dytë:

Pasi analizoi letrën më sipër Bordi vendosi

1. Të normojë pjesëmarrjen e EKR të IEKA-s në angazhimin e auditimit të pasqyrave financiare të shoqërive aksionare duke vendosur detyrimin që EKR të marrin përsipër misionin vetëm në rastin kur plotësohet kërkesa e nenit 42, pika 2 të Ligjit, (pra duhet të jenë të paktën 2 EKR). IEKA ju ka bërë me dije EKR-ve nëpërmjet një letëre informuese për këtë vendim të BMP-së.
 2. Të analizohet nga IEKA baza e të dhënave për numrin e subjekteve të angazhimeve të auditimit ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2012, numrin e orëve të punës dhe personelin ndihmës të cdo EKR apo shoqërie. Për ngarkesat që dalin tej normave të shifrave normale IEKA të bëjë planin e kontrollit të cilësisë.
- III. Shkresë e dërguar nga KKK në datë 15.12.2011 për disa Mangësi në zbatimin e standardeve të kontabilitetit në PF të disa njësive ekonomike:
- ka njësi ekonomike që nuk i kanë hartuar PF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
 - në raportet e auditimit për PF të këtyre njësive, ka pohime të ndryshme lidhur me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar për hartimin e këtyre pasqyrave financiare.

Vendimi i Bordit në lidhje me çështjen e tretë:

- ✓ Të kërkojë kopje të evidencës mbështetëse për audituesit që kanë parregullsi raportet e auditimit të lëshuara prej tyre.
 - ✓ T'i kërkojë EKR që kanë hartuar raportet e auditimit për PF të këtyre njësive një kopje të letrës së angazhimit dhe të raportit të auditimit.
 - ✓ Të ngarkojë një nga kontrollorët e cilësisë të BMP për të shqyrtuar dokumentacionin për këto çështje dhe për të përgatitur një relacion për BMP
 - ✓ Të thërrasë për të dhënë shpjegime në një nga mbledhjet e tij EKR të përmenduar në shkresën më sipër,
Në përfundim Bordi mori disa masa për EKR e përmendur në këtë shkresë.
- IV. Në vazhdim të letrave ankimese për mosrespektimin e ligjit për kohëzgjatjen në vite të kryerjes së auditimit në një shoqëri.

Vendimi i Bordit në lidhje me çështjen e katërt:

Në paragrafin 20.2 të Kodit të Etikës për EKR të shtoj pikën 12 me këtë përmbajtje:
“Duke filluar nga auditimet e Pasqyrave Financiare të vitit 2013, çdo Ekspert kontabël, që është person fizik apo eksperti kontabël, ortak kryesor i angazhimit i një shoqërie auditimi, që ka mbushur kohën a auditimit ligjor të pasqyrave financiare të një shoqërie prej 7 vite rresht duhet të zëvendësohet.

Personi fizik apo ortaku i angazhimit i shoqërisë së auditimit mund të rimarrë pjesë në auditimin e pasqyrave financiare të kësaj shoqërie vetëm pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën, dy vite rresht.”

4.3 Kontrolli i Cilësisë së Auditimit të Entiteteve me interes publik.

Në zbatim të nenit 3 të Ligjit të auditimit, BMP e kryen mbikqyrjen e profesionit të EKR dhe shoqërive audituese si drejtpërdrejt, duke mbikqyrur të gjithë ekspertët dhe shoqëritë e auditimit, ashtu dhe nëpërmjet mbikqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të EKR. Gjatë vitit 2011 BMP realizoi për herë të parë kontrollin e cilësisë të entiteteve me interes publik.

Gjatë vitit 2013 mbështetur në Rregulloren për Organizimin e Kontrollit të Cilësisë së Shoqërive me interes Publik, Bordi ftoi për të kandiduar dhe përzgjedhi shtatë Inspektorë që do të kryejnë kontrollin e cilësisë për auditimet e kryera në vitin 2013. Duke qënë se mënyra e kryerjes së kontrollit direkt nga ana BMP, ka qënë objekt i diskutimeve me konsulentët e Projektit të Bankës Botërore, për vitin 2013 BMP e ka kryer këtë kontroll dhe ka krijuar grupet e kontrollit.

4.4 Procesi i Certifikimit të kandidatëve për EKR dhe KM

Një nga funksionet e rëndësishme të BMP është mbikqyrja e procesit të certifikimit të kandidatëve për EKR dhe KM. BMP e ka monitoruar atë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pas përfundimit të këtij procesi Bordi ka marrë në analizë procesin e certifikimit të vitit 2013, problematikat dhe propozimet për përmirësimin cilësor të tij dhe ka vendosur:

- Dhënien e rekomandimeve Autoritetit të Certifikimit për të analizuar procesin e rikorrigjimit, për të identifikuar përgjegjësitë me qëllim shmangjen e diferencave të konsiderueshme të rezultatit të provimit midis procesit të korrigjimit dhe rikorrigjimit.
 - përmirësime në përdorimin e fondeve të grumbulluara për procesin e certifikimit të kandidatëve për KM dhe EKR, duke lejuar që një pjesë e tyre të përdoren për përmirësimin e performancës së AC;
 - disa korrigjime në rregullore që lejojnë zhvillimin e procesit të korrigjimit në ambiente të ndryshme nga të IEKA-s me kushtin që të sigurojnë integritetin e procesit;
 - heqjen e ndonjë kufizimi që ngurtëson procesin si p.sh. ora e fillimit të provimit i lihet Autoritetit të vendosë., etj
 - raportimi për realizimin e buxhetit të bëhet në muajin shkurt, meqense në muajin janar nuk janë përfunduar akoma pasqyrat financiare.
 - E të tjera.

5. Bashkëpunimi Institucional

5.1 Angazhimi i BMP në Projektin e Bankës Botërore CFREP Albania

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE është një proces mjaft dinamik, i cili varet nga përmbushja e kriterëve dhe vecanërisht nga aftësia e Shqipërisë për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme të *acquis communautaire* dhe transpozimin e tyre të plotë në sistemin ligjor shqiptar.

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe aplikimi për anëtarësim në BE, megjithëse janë në thelb dy procese të vecanta kërkojnë harmonizimin e legjislacionit dhe zbatimin e *acquis communautaire*, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative që të cojnë në fazën e ardhme të procesit të integritimit, në atë të pranimit në BE.

Në fushën e profesioneve të auditimit dhe kontabilitetit në Shqipëri ka filluar një projekt afat gjatë, që arrin shifrën 5-6 milion euro, i parashikuar dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të vendit tonë në kuadër të Programit Rajonal ROSC-REPARIS, të BB dhe FMN, për vendin tonë. Objektivi kryesor i këtij projekti është përafrimi me Direktivën e Auditimit ligjor të BE-se, ndaj është bërë rishikimi e kornizës statutore në dritën e kërkesave kryesore që parashikon neni 32 i Direktivës.

Projekti i plotë për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive kërkon të ndërlihdë një numër komponentësh dhe aktiviteteve të cilat së bashku do të përmirësojnë besueshmërinë, vlefshmërinë dhe qendrueshmërinë e raportimit financiar të shoqërive në Shqipëri duke përmirësuar klimën e investimeve, me anë të pesë komponentëve kryesore:

- ❑ Komponenti 1: Përmirësimi i ligjshmërisë të kornizës ligjore në fushën e raportimit financiar të shoqërive duke e përafruar me EU *acquis*;
- ❑ Komponenti 2: Fuqizimi i vendosjes së standardeve nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK);
- ❑ Komponenti 3: Përmirësimi i vendosjes të standardeve dhe mbikqyrja e praktikave të auditimit nga sistemi i mbikqyrjes;
- ❑ Komponenti 4: Përmirësimi i aftësive për të aplikuar standardet e reja profesionale me anë të rishikimit dhe përditësimit të kurrikulave të kontabilitetit dhe auditimit për edukimin profesional dhe universitar; dhe
- ❑ Komponenti 5: Përmirësimi i menaxhimit të reformave në raportimin financiar të shoqërive nga Komiteti Kombëtar Drejtues dhe Ministria e Financave.

Komponenti 3 i këtij programi lidhet direkt me BMP dhe ka filluar në gjysmën e dytë të vitit 2012. Raporti i fillimit që mbulon komponentin e tretë të projektit u dorëzua në Gusht 2012.

- Aktiviteti 1: Raporti i fillimit
- Aktiviteti 2: Sistemi i Mbikqyrjes Publike
- Aktiviteti 3: Regjistri Publik i EKR
- Aktiviteti 4: Përmirësimi i vendosjes të standardeve të auditimit
- Aktiviteti 5: Sigurimi i Cilësisë (Kontrolli dhe Disiplina)

BMP, si autoriteti i vetëm rregullator dhe mbikqyrës në fushën e profesioneve të kontabilitetit dhe auditimit është përfshirë në mënyrë aktive në takime dhe workshope të organizuara nga konsulentët e Projektit vecanërisht për çështje specifike të lidhura me aktivitetin 2 dhe 5.

- Vlerësimi i nivelit aktual të zhvillimit dhe propozimi i nje sistemi te mbikqyrjes publike funksional, eficient dhe të qëndrueshëm,
- Sqarimi i roleve dhe përgjegjësi të BMP dhe fusha e aktiviteteve që duhet të kryejë në kontekstin e direktivës të auditimit ligjor dhe mjedisit institucional lokal,
- Sqarimi i roleve dhe përgjegjësi të IEKA dhe anëtarëve të saj në lidhje me aktivitetet e mbikqyrjes publike,
- Sqarimi i dallimeve të rolit të IEKA-s si organizatë profesionale dhe BMP si organ mbikqyrës
- Vlerësimi i kapaciteteve institucionale të Bordit dhe të IEKA-s, propozimi i përmirësimeve në lidhje me stafin, buxhetin dhe rregullimin e financimeve.

5.2 BMP – Anetar i IFIAR

Që nga 12 shtator 2011 Bordi i Mbikqyrjes Publike është bërë anëtar i IFIAR - Forumi Ndërkombëtar i Mbikqyrësve Publike (International Forum of Independent Audit Regulators).

Objektivat e IFIAR janë:

- Të shkëmbejnë njohuritë dhe eksperiencën në fushën e auditimit me qëllim kryesor kontrollin e cilësisë së audituesve dhe firmave të auditimit.
- Të promovojnë bashkëpunimin në aktivitetin rregullues midis anëtarëve të IFIAR.
- Mundësimi i një platforme dialogu me organizata të tjera ndërkombëtare që kanë një interes për cilësinë e auditimit.

BMP ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me IFIAR nëpërmjet kontakteve elektronike me qëllim shkëmbimin e përvojës. Pjesëmarrja në veprimtaritë e organizuara nga IFIAR është një domosdoshmëri në njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit rregullative dhe mbikqyrëse, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave më të mira. Një faktor i rëndësishëm për intensifikimin e kontakteve me homologët ka qënë dhe mbetet nevoja e harmonizimit të legjislacionit rregullues të raportimit financiar me Direktivat e BE në kuadër të Marreveshjes së Stabilizim Asociimit.

5.3 Bashkëpunimi me organizmat kombëtare

Për përmbushjen e funksionit mbikqyrës BMP ka qënë në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Institucionet, organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, autoritetet dhe rregullatorët.

Me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare është ngritur Komiteti i Drejtimit me përfaqësues nga Ministria e Financave, BMP, KKK, IEKA.

Informacioni dhe ndihma e të gjitha palëve me të cilat Bordi i Mbikqyrjes Publike ka lidhur marrëveshje mirëkuptimi, për çdo rast që përbën shkelje të ligjit, që dyshohet për pastrim parash, që konstatohet evazion fiskal, kontrabandë, korrupsion, krim ekonomik, që dyshohet për konflikt interesi, etj dhe që njëra palë përfaqësohet nga një profesionist, kompani e shërbimeve profesionale qoftë ky auditues apo kontabilist i miratuar, do të jetë shumë i cmuar për realizimin me cilësi të misioneve të Bordit. Detyrimet ligjore, por dhe interesi kombëtar e kërkon që, Bordi Mbikqyrjes Publike të bëhet me dije për të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin. Për këtë do të këmbëngulet fuqishëm nga ana jonë.

BMP ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me Rregullatorë dhe Autoritete që veprojnë në fusha të ngjashme të ekonomisë dhe kanë funksione të përbashkëta si Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Autoriteti i Konkurrencës etj. Këto marrëveshje synojnë sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve mbi shkallën e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit prej ekspertëve kontabël të regjistruar dhe shoqërive audituese, kontabilistëve të miratuar, nivelit të kontrollit të cilësisë të punës së tyre si dhe kodit të etikës.

6. Sfida dhe Prioritete të BMP

Veprimtaria e Bordit gjatë vitit të katërt të punës së tij ka qënë e fokusuar jo vetëm në hartimin e akteve rregullative për kryerjen normale të veprimtarisë së tij dhe të vetë organizatave profesionale por edhe me ushtrimin e funksioneve të tij të mbikqyrjes dhe të kontrollit.

Bordi i Mbikqyrjes Publike hartoi dhe miratoi Programin e Punës për Vitin 2014. Në këtë seksion ne kemi percaktuar temat kryesore brenda programit tonë të punës me këto prioritete:

- Prioritetet për aktivitetin e Bordit të Mbikqyrjes Publike për vitin 2014

1. Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet e organizuara nga IFIAR.
2. Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative.
3. Angazhimi në projektin e Bankës Botërore - CFREP.
4. Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2014 të organizuara nga AC-ja

- Implementimi i prioriteteve

Bordi i Mbikqyrjes Publike, për vitin 2014, do të vazhdojë të fokusojë punën në fushat e mëposhtme:

- mbikqyrjen e kontrollit të cilësisë së auditimeve të shoqërive me rëndësi për ekonominë e vendit tonë (me interes publik), duke realizuar kontrollin si në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Bordi ashtu edhe nëpërmjet organizatës profesionale;
- Mbikqyrjen e programeve të edukimit dhe të kualifikimit të vazhdueshëm profesional si të audituesve edhe të profesionistëve kontabël;
- Mbikqyrjen e veprimtarisë së certifikimit;
- Mbikqyrjen e veprimtarisë së regjistrimit;
- Dhënien e rekomandimeve të nevojshme për përmirësimin e punës.

6.2 Kuadri i ri rregullator ligjor

Në bashkëpunim me të gjitha palët e përfshira në projektin e BB gjatë vitit 2013 kemi identifikuar të gjitha nevojat dhe problemet për ndërhyrje dhe amendim të Ligjit nr 10091 datë 05.03.2009 me qëllim harmonizimin më të mirë të detyrimeve që përcakton ai në implementim dhe forcimin pavarësisë së strukturave, të cilësisë të punës së tyre dhe forcimin e cilësisë së raportimit financiar dhe transparencës në Shqipëri.

Për këtë qëllim janë hartuar Termat e Referencës, për zgjidhjen e tyre së bashku me ekspertët e huaj, në kuadër të projektit të programit ROSC-REPARIS.

Për sigurimin e një sistemi të mbikqyrjes publike funksional, eficient dhe të qëndrueshëm, parashikojmë që në bashkëpunim me strukturat qeverisëse dhe konsulentët e Projektit:

- ✓ Të modifikohet procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të BMP,
- ✓ BMP të bëhet person juridik dhe të veprojë si entitet i vecantë,
- ✓ Të konkludohet në zgjidhjen e financimit të sistemit të mbikqyrjes publike,
- ✓ Të qartësohet roli dhe përgjegjësitë në sistemin e kontrollit të cilësisë,
- ✓ Të qartësohet roli dhe përgjegjësitë në sistemin e Investigimit e Disiplinës,
- ✓ Sqarimi i dallimeve të rolit të IEKA-s si organizatë profesionale dhe BMP si organ mbikqyrës.
- ✓ Etj.

Në analizë të fundit ne shprehim bindjen se krijimi i BMP ka filluar dhe do të vazhdojë të japë impakte pozitive në fushën e Raportimit Financiar, auditimit, të dhënies së sigurisë për përmirësimin e cilësisë së tyre, për krijimin e një klime biznesi motivuese dhe transparente ndaj publikut dhe forcimin e shtetit ligjor.